



Plannar / Dorezuar Prilbena/Prodato Received/Delivered	13.02.2024	5	VITI GJATË VITIT
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHKQ	850/2024		117



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.nr.1534/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Atdhe Gashi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1534/2023 të datës 18.12.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër vendimit me numër protokollit 32 të datës 22.11.2023 të Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 13.02.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1534/2023 e datës 18.12.2023 e parashtruar nga ankuesja ndërsa lënda kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* të Drejtorit i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit.
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokollit 32 i datës 22.11.2023 i Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit dhe Shtojca: Orari i punës jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, punën gjatë fundjavës dhe punën gjatë festave.
- III. Obligohet Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë rishqyrtimin e rastit që ndërlidhet me Orarin e punës jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, punën gjatë fundjavës dhe punën gjatë festave në kuadër të Qendrës për Punë Sociale.

IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Rahovecit, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesja (tutje vetëm ankuesja), e punësuar sipas Akt emërimit me 01Nr.2524 të datës 18.06.2013 në pozitën e punës "Zyrtare për Shërbime Sociale" në Qendrën për Punë Sociale pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Rahovecit, me datë 18.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1534/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër zbatimit të Vendimit me numër protokoll 32 të datës 22.11.2023 të Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se Vendimi me numër protokoll 32 i datës 22.11.2023 i Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit me të cilin është përcaktuar orari i punës jashtë orarit të rregullt, puna gjatë kujdestarisë, puna gjatë fundjavës dhe puna gjatë festave zyrtare për Zyrtarët e Shërbimit Social në Komunën e Rahovecit nuk është duke u zbatuar sipas dispozitave ligjore për orarin dhe orët e punës, pasi që ka orar të stërzgatur dhe të pa planifikuar të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 29.12.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Rahovecit. Ndërsa Këshilli, me datë 30.01.2024 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokoll 546/2024, të datës 29.01.2024, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1534/2024, të datës 18.12.2023.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Plotësimin e ankesës të ankueses H.T të datës 29.01.2024; Ankesën me numër protokoll 7535 të datës 18.12.2023 të parashtruar nga ankuesja H.T në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoll 3291 të datës 01.11.2023 të Kryetarit të Komunës së Rahovecit; Vendimin me numër protokoll 32 të datës 22.11.2023 të Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit; Orarin e punës jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, punën gjatë fundjavës dhe punën gjatë festave; Ankesën e parashtruar nga ankuesja tek Drejtori i QPS në Komunën e Rahovecit; Përgjigjen në ankesë të datës 08.12.2023 të Drejtorit të QPS së Komunës së Rahovecit dërguar ankueses H.T; Akt emërimin e ankueses me 01Nr.2524 të datës 18.06.2013; Përshkrimin e detyrave të punës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim dhe rivendosje, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas Akt emërimit me 01Nr.2524 të datës 18.06.2013 mban pozitën e punës "Zyrtare për Shërbime Sociale", në Qendrën për Punë Sociale pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Rahovecit, ndërsa Kryetari i Komunës së Rahovecit me vendimin me numër protokolli 3291 të datës 01.11.2023 autorizon Zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale duke përfshirë edhe ankuesen që te punojnë jashtë orarit të rregullt të punës, gjatë festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës, tutje në zbatim të këtij vendimi Drejtori i Qendrës për Punë Sociale ka nxjerr Vendimin me numër protokolli 32 të datës 22.11.2023 lidhur me organizimin dhe caktimin e orarit vjetor dhe punës ne grupe për angazhimin e Zyrtarëve të Shërbimeve Sociale për të punuar jashtë orarit të rregullt të punës, gjatë fundjavës dhe gjatë festave zyrtare duke përfshirë edhe Shtojcën mbi caktimin e Orarit të zyrtareve të lartpërmendur për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, gjatë fundjavës dhe punën gjatë festave.

Ankuesja e pakënaqur me zbatimin e Vendimit të lartpërmendur, konkretisht me orarin e stërzgatur të punës jashtë orarit të rregullt dhe kompensimet lidhur me punën jashtë orarit të rregullt të punës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Vendimi me numër protokolli 32 i datës 22.11.2023 i Drejtori të Qendrës për Punës Sociale në Komunën e Rahovecit dhe rrjedhimisht Shtojca për orarin e lartë përmendur të punës është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës si dhe e njëjta kërkon kompensimin e për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, punën gjatë fundjavës dhe punën gjatë festave zyrtare.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se Vendimi me numër protokolli 32 të datës 22.11.2023 i Drejtori të Qendrës për Punë Sociale është nxjerr përmes shkelleve esenciale të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, konkretisht se orari i caktuar për punën jashtë orarit të rregullt është i stërzgatur, analizoi legjislacionin përkatës që rregullon, punën jashtë orarit të rregullt të punës, punën gjatë festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës si dhe dispozitat përkatëse që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, gjegjësisht:

Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik përkatësisht nenin 21 paragrafi 1 dhe 2 ku është përcaktuar se: „ Orari i punës, vijueshmëria dhe pushimet e zyrtares/it publik 1. Orari i punës dhe pushimet e zyrtares/it publik rregullohen në përputhje me legjislacionin përkatës për punë. 2. Kriteret dhe kushtet për zbatimin e këtij neni përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Punë”, ndërlidhur me nenin 4, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se: “1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës zyrtari publik kryen punë ose shërbime në të mirë të institucioni. 2. Orari i punës së zyrtarëve publik fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00, pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premtën, përveç nëse caktohet ndryshe nga institucioni përkatës për shkak të natyrës

së punës”, dhe nenit 8, paragrafi 1, 2 dhe 3 ku përcaktohet se: “1. Në raste të veçanta, për shkak të rritjes së vëllimit të punëve dhe/apo në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e institucionit, zyrtari publik duhet të punojë jashtë orarit, apo të caktohet kujdestar, të punojë gjatë natës, gjatë festave zyrtare, apo gjatë fundjavës. 2. Puna jashtë orarit mund të zgjasë për sa vlerësohet e domosdoshme nga institucioni, por jo më shumë se tetë (8) orë në javë. 3. Puna që e tejkalon kufirin e përcaktuar sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni mund të bëhet edhe në rastet emergjente për parandalimin e aksidenteve ose forcave madhore të paparashikuara.”,

Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës përkatësisht nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 ku është përcaktuar se: 1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës i punësuar kryen punë ose shërbime në të mirë të punëdhënësit. 2. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.” si dhe neni 23 paragrafi 1,2 dhe 3 i këtij ligji ku është përcaktuar se „1. Në raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë me gjatë se orari i punës (puna jashtë orarit), më së shumti deri në tetë (8) orë në javë. 2. Puna më e gjatë se orari i plotë i punës, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, mund të zgjasë vetëm për aq kohë sa është e domosdoshme. 3. Puna që e tejkalon kufirin e përcaktuar sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të bëhet edhe në rastet emergjente për parandalimin e aksidenteve ose forcave madhore të paparashikuara”.

Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik përkatësisht neni 35 paragrafi 1, 2 dhe 3 ku përcaktohet se: “1. Kompensimet që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare”, dhe Nenin 36 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se:” 1. Zyrtarët/ët publik/e dhe kategoritë e tjera të të punësuarave/ëve që paguhen nga buxheti i shtetit, përjashtimisht funksionareve/ëve publik/e përfitojnë kompensim në vlerë monetare apo me pushim për punën me kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, punën në fundjavë, punën në ditët e festave zyrtare. 2. Kompensimi sipas paragrafit 1. të këtij neni paguhet në përqindje të pagës bazë sipas ligjit përkatës për punë, si më poshtë: 2.1. 20 % në orë për kujdestari; 2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës; 2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit; 2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 2.5. 50 % në orë për punë gjatë fundjavës”, ndërlidhur këtu me nenin 4 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.07/2023 për Kompensimin për Kujdestari, Punën Gjatë Natës dhe Punën Jashtë Orarit të Punës ku theksohet se: “1. Zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përfitojnë kompensim në vlerë monetare apo me pushim për punën në kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, punën në fundjavë dhe punën në ditët e festave zyrtare. 2. Kompensimi bëhet për rastet si në vijim: 2.1. për kujdestari - në vlerë prej njëzet për qind (20%) në orë; 2.2. punën gjatë natës - në vlerë prej tridhjetë për qind (30%) në orë; 2.3. punën jashtë orarit të rregullt të punës - në vlerë prej tridhjetë për qind (30%) në orë; 2.4. punën gjatë ditëve të festave zyrtare - në vlerë prej pesëdhjetë për qind (50%) në orë; dhe 2.5. punën gjatë fundjavës - në vlerë prej pesëdhjetë për qind (50%) në orë. 3. Përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe me legjislacionin në fuqi, vlera totale e kompensimit për punën shtesë nga orari i rregullt, nuk mund të jetë më e lartë se 1% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore në kategorinë e shpenzimeve “Paga dhe Shtesa” të atij viti fiskal.”, dhe nenin 7, 8 dhe 9 ku përcaktohet se: 7. “Zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, kanë të drejtë të kompensohen për punën jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës. 2. Puna jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës mund të realizohet vetëm kur i punësuar ka pëlqim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë

dhe ka autorizim paraprak të arsyetuar nga udhëheqësi më i lartë i institucionit. 3. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, punën gjatë festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës bëhet me pagesë ose me ditë pushimi. 4. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, punën gjatë festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës, llogaritet për çdo orë pune, duke i shtuar edhe vlerën si vijon: 4.1. Tridhjetë për qind (30%) në orë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 4.2. Pesëdhjetë për qind (50%) në orë për punën gjatë fundjavës; 4.3. Pesëdhjetë për qind (50%) në orë për punën jashtë orarit gjatë festave zyrtare. 5. I punësuari mund të kërkojë nga institucioni që në vend të kompensimit në vlerë monetare sipas paragrafit 4 të këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi. 6. Në pajtim me ligjin përkatës për punë, institucioni mund të vendosë që puna jashtë orarit të rregullt të kompensohet me ditë pushimi. 7. Kompensimi për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira e përjashtojnë njëra tjetrën. 8 "1. Kompensimi për punë jashtë orarit të rregullt të punës, gjatë festave zyrtare apo gjatë ditëve të fundjavës bëhet vetëm në rastet kur plotësohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 7 të kësaj Rregulloreje. 2. Kërkesa për kompensim për punë jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës aprovohet nga zyrtari më i lartë administrativ i institucionit më së largu dhjetë (10) ditë pas përfundimit të orëve shtesë, duke plotësuar Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje. 3. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës duhet të ekzekutohet më së largu gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e aprovimit të kërkesës.", Neni 9 Kushtet dhe planifikimi i buxhetit për pagesën e kompensimeve 1. Institucionet publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet dorëzojnë në Ministrinë përgjegjëse për financa shumë buxhetore të nevojshme për kompensime për institucionin përkatës, sipas përcaktimeve të ligjit përkatës të pagave dhe kësaj Rregulloreje. 2. Çdo kompensim i përcaktuar me këtë Rregullore nuk mund të realizohet, nëse nuk është e planifikuar në buxhetin vjetor të institucionit përkatës.

Rrjedhimisht duke ju referuar dispozitave të lartcekura Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja ka të drejtë të kompensohet për punën e kryer jashtë orarit të rregullt të punës, punën gjatë fundjavës dhe punën gjatë festave zyrtare, nga fakti se e njëjta ka ofruar dëshmi se ka punuar jashtë orarit të rregullt të punës duke përfshirë edhe ditët e fundjavës dhe ditët e festave zyrtare, dhe këtë fakt e ka konfirmuar edhe Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit përmes emailit të datës 8.12.2023, ndërsa sa i përket orarit të stërzgatur të punës jashtë orarit të rregullt të punës që është edhe pretendim ankimor i bazuar sepse Vendimi me numër protokollit 32 të datës 22.11.2023 i Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale lidhur me organizimin dhe caktimin e orarit vjetor dhe punës në grupe për angazhimin e Zyrtarëve të Shërbimeve Sociale për të punuar jashtë orarit të rregullt të punës, gjatë fundjavës dhe gjatë festave zyrtare duke përfshirë edhe Shtojcën mbi caktimin e Orarit të zyrtarëve të lartpërmendur për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, gjatë fundjavës dhe punën gjatë festave është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartë cekura, respektivisht në kundërshtim me nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimit të Zyrtarëve Publik, sepse për zyrtarët e angazhuar për punën jashtë orarit duke përfshirë edhe ankuesen është tejkalluar numri i orëve të punës prej tetë (8) orë në javë gjegjësisht në rastin konkret kemi orar të stërzgatur dhe mos planifikim të mirëfilltë të kujdestarisë sepse sipas Shtojcës mbi caktimin e Orarit të zyrtarëve të shërbimeve sociale për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, gjatë fundjavës dhe punën gjatë festave janë caktuar gjashtë Zyrtar për Shërbime Sociale, ndërsa bazuar nga shkresat e lëndës gjegjësisht nga

përgjigja në ankesë e Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale e datës 13.12.2023 drejtuar ankueses në pikën 2 ai thekson se *citoj se: unë i kam parasysht shqetësimet e tua , se tani Shërbimi Social ka mbetur në dy zyrtarë aktiv për punuar jashtë orarit, vikendeve dhe ditëve të festave ngase 2 pozita tjera të Zyrtarëve të Shërbimit Civil janë vakante-të pa plotësuar, ndërsa zyrtare tjera të shërbimit civil për shkak të shtatzënisë janë liruar nga angazhimi në punë jashtë orarit, vikendeve dhe ditëve festive sipas ligjit''*, rrjedhimisht nga deklarimi i Drejtorit nënkuptohet se zbatimi i këtij Vendimi dhe Shtojcës mbi orarin vjetor është pothuajse i pamundur pasi që ka mungesë të stafit gjegjësisht shumica e zyrtarëve për shërbime sociale të caktuar sipas Vendimit me numër protokolli 3291 të datës 01.11.2023 të Kryetarit të Komunës Rahovecit nuk janë duke punuar apo janë liruar nga puna jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës, gjatë fundjavës dhe punën gjatë festave gjegjësisht gjithnjë duke u bazuar në deklarimin e Drejtorit orari i caktuar nga vete ai është duke u zbatuar vetëm nga dy zyrtar, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit Vendimi me numër protokolli 32 i datës 22.11.2023 i Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit gjegjësisht Shtojca e Orarit vjetor mbi caktimin e angazhimit të Zyrtarëve të Shërbimeve Sociale për punën jashtë orarit të rregullt të punës është i paqartë, kundërthënës dhe gabimisht është zbatuar ligji material, andaj në kuptim të dispozitave ligjore ky akt është i paligjshëm sipas nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj Kolegji i Këshillit konstaton se lidhur me kërkesën e ankueses si dhe duke marrë për bazë dispozita ligjore të specifikuara si më lartë është e domosdoshme që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe ri vendosje tek autoriteti punëdhënës konkretisht tek Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në mënyrë që ky i fundit mbi bazën e konstatimit të gjendjes faktike dhe pikëpamjeve juridike të dhëna si në arsyetim të këtij vendimi dhe me qëllim të mos diskriminimit të zyrtarëve aktiv të angazhuar në punën jashtë orarit të rregullt të punës të vendos në mënyrë meritore lidhur me pretendimet ankimore të ankueses dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me deponat ligjore në fuqi që rregullojnë orarin e punës dhe punën jashtë orarit të rregullt të punës respektivisht i njëjti duhet të kujdeset që gjatë përpilimit të Orarit vjetor mbi caktimin e angazhimit të Zyrtarëve të Shërbimeve Sociale për punën jashtë orarit të rregullt të punës të ketë numër të mjaftueshëm të zyrtarëve për kryerjen e këtyre detyrave të punës rrjedhimisht në rast se kemi pozita të lira këto pozita duhet plotësohen me zyrtare tjerë sipas procedurës së rekrutimit apo sipas procedurës së transferit në mënyrë që mos të tejkalohet numri i orëve të punës jashtë orarit prej tetë (8) orë në javë ashtu siç përcaktohet në nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimit të Zyrtarëve Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu ka konstatuar se Vendimi me numër protokolli 32 i datës 22.11.2023 i Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit është paligjshëm duke u bazuar në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligj "* ngase Vendimi i lartpërmendur është nxjerr duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik, i cili ligj ka qenë i shfuqizuar sipas nenit 104 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik i cili ka hyre në fuqi me datë 26.09.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1534/2023.

Atdhe Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dorëzohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Rahovecit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Rahovecit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

